



Funded by  
the European Union

# Reformimi i Skemës së **Ndihmës Sociale**



Qershor 2022

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

# Reformimi i Skemës së Ndhmës Sociale

Qershor 2022

## Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## — Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Hyrje   | 3  |
| Skema e Ndhmës Sociale                          | 4  |
| Shkalla e varfërisë në Kosovë                   | 7  |
| Nisma për reformimin e Skemës për Ndhmë Sociale | 8  |
| Kredia e Bankës Botërore                        | 12 |
| Përfundim                                       | 13 |



Funded by  
the European Union

KOSOVO 2.0

 INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE

## Hyrje

Më 29 shtator 2021, Bordi i Drejtorëve të Bankës Botërore aprovoi kredinë për Reformimin e sistemit të ndihmës sociale në Kosovë, projekt i cili ka për qëllim përmirësimin e skemës së ndihmës sociale dhe programet e mbrojtjes sociale.<sup>1</sup> Programi për reformën e ndihmës sociale përfshin mbështetje financiare nga Banka Botërore (BB) prej 47 milionë euro, e dhënë në formë të kredisë me interes të ulët dhe me afat kthimi prej 30 vitesh.<sup>2</sup>

Përmes këtij projekti, BB mbështet Qeverinë e Kosovës për (a) reformimin e Skemës së Ndhmës Sociale (SNS); (b) investime në sistemin e ndarjes të ndihmës sociale; dhe (c) rritjen e shumës së ndihmës sociale për të zbutur efektet e pandemisë Covid-19.

Një muaj më vonë, më 26 tetor 2021, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe BB nënshkruan edhe zyrtarisht marrëveshjen në Prishtinë.<sup>3</sup> Më 10 dhjetor 2021, Qeveria aprovoi Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të "Projektit të reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale" mes Kosovës dhe BB.<sup>4</sup>

Prej 47 milionë eurove kredi, Qeveria planifikon që mbi 43 milionë euro t'i shpenzojë në subvencione, apo si pagesë për përfituesit e ndihmës sociale. Pikërisht, ky fakt ka bërë që Kuvendi të mos e aprovojë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për financim me BB. Në seancën plenare të Kuvendit më 21 janar 2022, Projektligji nuk grumbulloi 2/3 e votave të deputetëve, të nevojshme për aprovimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>5</sup> Kjo bëri që për herë të parë në historinë e funksionimit të Kuvendit të Kosovës të refuzohet një marrëveshje ndërkombëtare.

Duke mos pranuar dështimin e marrëveshjes si dhe duke refuzuar që të ndryshojë kushtet e kredisë me BB, më 23 mars 2022, Qeveria aprovoi sërish Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së financimit me BB dhe të njejtin e dërgoi në Kuvend. Në seancën plenare të Kuvendit më 11 maj 2022, sërish projektligji dështoi të marr votat e nevojshme.

Në këtë raport të shkurtër, Instituti GAP do të analizojë problemet aktuale me Skemën e Ndhmës Sociale, historikun e përpjekjeve për reformimin e kësaj skeme, marrëveshjen financiare në mes të MFPT dhe BB si dhe lëshimet në vlerësimin e ndikimit financiar.

1 World Bank. Kosovo to Improve its Social Assistance System, with World Bank Support. 29 shtator 2021.

Burimi: <https://bit.ly/3O1DCbS>

2 Kuvendi i Kosovës. Marrëveshja e financimit. Burimi: <https://bit.ly/38A33fa>

3 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ministri Murati nënshkruan marrëveshjen për "Projektin e Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë" me drejtorin e Bankës Botërore për Kosovë Massimiliano Paolucci. 26 tetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3vL6szO>

4 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.9/47. 10 dhjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3Kf525S>

5 Kuvendi i Kosovës. Vendimi nr.08-V-179. 21 janar 2022. Burimi: <https://bit.ly/3rVEWi0>

# Skema e Ndhmës Sociale

Në mars të vitit 2000, Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) themeloi Departamentin Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, një nga funksionet e të cilit ishte "ofrimi i ndihmës sociale sa më shumë që të jetë e mundur për familjet dhe individët nevojtarë".<sup>6</sup>

Pas zgjedhjeve të para parlamentare dhe formimit të institucioneve vendore, një ndër ligjet e para që u aprovua nga Kuvendi i Kosovës ishte edhe Ligji për skemën e ndihmës sociale.<sup>7</sup> Sipas Ligjit, SNS ofron ndihmë financiare familjeve të përzgjedhura në përputhje me kriteret financiare dhe jofinanciare që përcaktohen me ligj dhe me rregulla të ministrisë përkatëse.<sup>8</sup>

Për të përfituar ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet t'i plotësojnë kushtet për klasifikim në njërën prej dy kategorive:

**Kategoria e parë:** Familja në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar;

**Kategoria e dytë:** Familje me një anëtar/e të aftë për punë, por i/e cili/a është i/e papunë, me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç, ose që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.

**Figura 1.** Kriteret për kualifikim për Skemën e Ndhmës Sociale

## Ndihma Sociale



### Kategoria 1

- Të gjithë anëtarët e familjes janë **persona të varur\***, dhe
- Asnjëri nga anëtarët e familjes nuk është i punësuar

#### \*persona të varur:

- personat > 18 vjeç me aftësi të kufizuara të përhershme të paaftë për punë,
- personat > 65 vjeç,
- kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara, > 65 vjeç, fëmijës pesë vjeç etj.

### Kategoria 2

#### Një anëtarë i familjes i aftë për punë dhe:

- me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç.
- kujdestarët e përhershëm të një fëmije jetim <15 vjeç

### Beneficionet shtesë:

- Subvencionimi i energjisë elektrike deri në 400 Kwh në muaj,
- Lirimi nga shpenzimet e ujit dhe ngrohjes (nga disa komuna dhe kompani),
- Lirimi nga taksat komunale (në disa komuna),
- Mbulimi i shpenzimeve për regjistrimin e semestrave në universitete publike, etj.

Burimi: GAP, bazuar në Ligjin për skemën e ndihmës sociale


6 Gazeta Zyrtare e UNMIK. Rregullore nr.2000/10. 3 mars 2000. Burimi: <https://bit.ly/37Tv6WZ>

7 Kuvendi i Kosovës. Evidenca e Ligjeve. Burimi: <https://bit.ly/30F2DEY>

8 Gazeta Zyrtare e Kosovës. Ligji nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale

Sipas këtyre kriterëve, nga viti 2001 e deri në mars 2022, mesatarisht ndihma sociale marrin rreth 34 mijë familje, si dhe mesatarisht 140 mijë anëtarë të këtyre familjeve. Numri i familjeve dhe anëtarëve përfitues ka rënë nga viti 2003 e këndej.<sup>9</sup> Në këtë rënie ka ndikuar edhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për skemën e ndihmës sociale në vitin 2012, posaçërisht kriteret e përzgjedhjes në Kategorinë e II-të, përkundër faktit se parametrat e varfërisë dhe papunësisë nuk tregojnë përmirësime. Numri i përfituesve të ndihmës sociale ka shënuar rënie të dukshme, nga 36,129 familje (2010) në 25,736 në vitin muajt e parë të vitit 2022.<sup>10</sup>

**Figura 2.** Numri i familjeve dhe numri i anëtarëve në Skemën e Ndhmës Sociale nga viti 2001 e deri në mars 2022



Burimi: GAP, bazuar në raportet e ASK për mirëqenien sociale (2003–2022)

Vlera monetare për përfituesit e ndihmës sociale ndryshon nga madhësia e familjes dhe kjo vlerë ka ndryshuar nga viti 2003 e deri më 2018, siç është paraqitur në tabelën numër 1.

**Tabela 1.** Kompensimi mujor për familjet që përfitojnë nga Skema e Ndhmës Sociale

|                       | Kompensimi mujor në Euro (€) |           |           |           |           |
|-----------------------|------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
|                       | 2003–2004                    | 2005–2006 | 2008–2014 | 2015–2017 | 2018–2022 |
| Familja me 1 anëtar/e | 34                           | 35        | 40        | 50        | 60        |
| Familja me 2 anëtarë  | 47                           | 50        | 55        | 68.75     | 82.5      |
| Familja me 3 anëtarë  | 52                           | 55        | 60        | 75        | 90        |
| Familja me 4 anëtarë  | 57                           | 60        | 65        | 81.25     | 97.5      |
| Familja me 5 anëtarë  | 62                           | 65        | 70        | 87.5      | 105       |
| Familja me 6 anëtarë  | 67                           | 70        | 75        | 93.75     | 112.5     |
| Familja me 7 anëtarë  | 72                           | 75        | 80        | 100       | 120       |
| Familja me 8 anëtarë  | 77                           | 80        | 85        | 106.25    | 127.5     |
| Familja me 9 anëtarë  | 82                           | 85        | 90        | 112.5     | 135       |
| Familja me 10 anëtarë | 87                           | 90        | 95        | 118.75    | 142.5     |
| Familja me 11 anëtarë | 92                           | 95        | 100       | 125       | 150       |
| Familja me 12 anëtarë | 97                           | 100       | 105       | 131.25    | 157.5     |
| Familja me 13 anëtarë | 102                          | 105       | 110       | 137.5     | 165       |
| Familja me 14 anëtarë | 107                          | 110       | 115       | 143.75    | 172.5     |
| Familja me 15 anëtarë | 112                          | 115       | 120       | 150       | 180       |


Burimi: GAP, bazuar në raportet e ASK për mirëqenien sociale (2003–2022)

<sup>9</sup> ASK. Raportet periodike për shëndetësinë dhe mirëqenien sociale nga viti 2001.

<sup>10</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (e cila nga viti 2021 është shkëputur në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve). Strategjia Sektoriale 2018–2022. Burimi: <https://bit.ly/3EZx7Zl>

Nga viti 2003 e deri më 2022, nga buxheti i shtetit janë shpenzuar mesatarisht 32 milionë euro në vit për SNS, apo në total për dy dekada janë shpenzuar 641 milionë euro. Përkundër asaj se buxheti për SNS ka mbetur thuajse i njejtë (me përjashtim të viteve 2020–2022, ku për shkak të pandemisë janë rritur transferet për këtë kategori me vendime të ndryshme qeveritare), pesha e SNS në buxhetin total shtetëror ka shkuar duke rënë.

**Figura 3.** Buxheti për SNS dhe pesha që zë në shpenzimet totale vjetore nga buxheti i shtetit, 2003–2022



Burimi: GAP, bazuar në raportet e ASK për mirëqenien sociale (2001–2022) dhe platformën e GAP për shpenzimet buxhetore

Po ashtu, buxheti për SNS ka mbetur thuajse i pandryshuar, përkundër asaj se buxheti për subvencione sociale është rritur vazhdimisht si pasojë e themelimit të skemave të reja sociale.

Sipas BB-së, ndihma sociale në Kosovë u zvogëluar si pjesë e shpenzimeve për mbrojtjen sociale gati trefish mes viteve 2009 dhe 2019. Shpenzimet për SNS ranë për 8.4% në terma realë dhe nga 0.69 në 0.45% të GDP. Vetëm rreth 7% e popullsisë së përgjithshme përfiton nga SNS, ndërsa shkalla zyrtare e varfërisë është rreth 20%. Vetëm një në katër persona në kuantilin e ulët marrin ndihmë sociale.<sup>11</sup>

11 World Bank. Western Balkans Social Protection Situational Analyses – Kosovo. 2022. Source: <https://bit.ly/3kqlcio>


## Shkalla e varfërisë në Kosovë

Shkalla e varfërisë në Kosovë ka shkuar duke rënë vazhdimisht që nga vitet e pasluftës. Në vlerësimin e parë për varfërinë, të bërë në vitin 2000, të gjeturat e BB tregonin se mbi gjysma e popullsisë (50.3%) jetonin në varfëri, kurse 11.9% e popullsisë jetonte në varfëri të skajshme.<sup>12</sup> Shtatë vite më vonë, nivelet e varfërisë kishin shënuar një rënie të vogël, apo 45% e popullsisë jetonte në varfëri, kurse varfëria e skajshme ishte rritur në 15%.<sup>13</sup>

Të dhënat më të fundit që janë publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ato për vitin 2017, tregojnë se shkalla e varfërisë në Kosovë ishte 18% (ata që jetojnë me 1.85 euro në ditë), kurse varfëria e skajshme 5.1% (ata që jetojnë me 1.31 euro në ditë).<sup>14</sup> Pandemia e Covid-19, e cila u shfaq edhe në Kosovë, në vitin 2020, bëri që shkalla e varfërisë të rritet gjatë vitit 2020, por shënoi një rënie në vitin 2021. Sipas BB, varfëria në Kosovë në fund të vitit 2021 është 20.9%.<sup>15</sup>

Rritja e çmimeve të konsumit dhe kriza e shkaktuar nga lufta në Ukrainë pritet që të rris varfërinë në Kosovë edhe më shumë. Por, edhe para pandemisë Covid-19 dhe para krizës së çmimeve, kompensimi mujor për familjet që marrin ndihma sociale ishte i vogël dhe i pamjaftueshëm për t'i nxjerrë ata nga varfëria. Nëse bazohemi në kompensimin mujor në bazë të madhësisë së familjes dhe shkallën e vitit 2017 për varfërinë prej 1.85 euro në ditë, del se të gjitha familjet me dy e më shumë anëtarë vazhdojnë të mbesin të varfër edhe pas marrjes së ndihmës sociale.

**Figura 4.** Mbulueshmëria e varfërisë me SNS sipas madhësisë së familjes



12 World Bank. Kosovo Poverty Assessment, Volume II. Report no.23390-KOS. 20 dhjetor 2001.

13 ASK dhe BB. Vlerësimi i varfërisë në Kosovë. 3 tetor 2007. Burimi: <https://bit.ly/3LsRXY1>

14 ASK dhe BB. Varfëria në konsum. Maj 2019. Burimi: <https://bit.ly/38C8Uks>

15 World Bank. Greening the recovery – Western Balkans Regular Economic Report No.20. Fall 2021.

Burimi: <https://bit.ly/38sY0xc>

Për tu përgjigjur ndaj pasojave të pandemisë, qeveritë që nga viti 2020 kanë marr masa të ndryshme për të rritur ndihmën për familjet që janë pjesë e SNS. Më 30 mars 2020, Qeveria aprovoi Pakon e emergjencës sociale prej afër 180 milionë eurosh, ku masa e parë parashihte edhe dyfishimin e ndihmës sociale për familjet përfituese për muajt prill dhe maj të vitit 2020 dhe në total për këtë masë u ndanë 7.65 milionë euro.<sup>16</sup>

Pas krijimit të qeverisë së re, më 13 gusht 2020 u aprovua Programi i rimëkëmbjes ekonomike prej 360 milionë euro<sup>17</sup>, prej të cilave 7.5 milionë euro për dyfishimin e asistencës sociale për tre muajt e fundit të vitit 2020.<sup>18</sup>

Më 14 korrik 2021, qeveria e dalë nga zgjedhjet parlamentare të muajit shkurt 2021, aprovoi Pakon e ringjalljes ekonomike në vlerë prej 423 milionë eurove, ku masa 3.2 parasheh edhe subvencionimin e familjeve në ndihmë sociale me 30% mbi shumën e asistencës që marrin zakonisht.<sup>19</sup> Kurse në muajin prill të vitit 2022 Qeveria u ndau nga 100 euro shtesë familjeve në SNS.

Masa 3.3 e Pakos për ringjalljen ekonomike parasheh edhe ndarjen e 12 milionë eurove për reformimin e skemës sociale, me arsyetimin se 'pandemia ka shpërfaqur problemet sa i përket dizajnimin të skemës së ndihmës sociale ngase shumë familje në nevojë mbesin jashtë kësaj skeme'. Sipas Qeverisë, në bashkëpunim me BB, do të reformohet skema e ndihmës sociale, me qëllim zgjerimin e saj për të përfshirë më shumë familje në nevojë dhe se shuma e përgjithshme e projektit pritet të jetë 47 milionë euro.

## Nisma për reformimin e Skemës për Ndhimë Sociale

Problemet me sistemin e ndihmës sociale ishin shfaqur shumë kohë para pandemisë. Me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) 2018-2022, e cila u aprovua në dhjetor të vitit 2017, identifikoheshin edhe problemet me SNS.<sup>20</sup> Sipas Strategjisë, vlera mujore e ndihmës sociale nuk është përshtatur me çmimet ashtu siç parashihet me ligj. Shumat e kompensimit mujor janë më të ulëta edhe se kufiri i varfërisë. Sistemi i mbrojtjes sociale karakterizohet me mospërputhje dhe pabarazi në mes të skemave në aspektin e mjaftueshmërisë së përfitimeve materiale. Shuma mujore e SNS për person është me e ulët në krahasim me të gjitha skemat tjera.<sup>21</sup>

Posaçërisht kriteri i së paku një fëmije 5-vjeç për po të njëjtën kategori të përfituesve paraqet problem në mbulimin e familjeve të varfëra nga skema, duke marrë parasysh se gjendja financiare e ekonomive familjare përkeqësohet me vijimin e shkollimit të fëmijës. Sipas një studimi të UNICEF, rreziku më i lartë i varfërisë së fëmijëve është për ata fëmijë ku të ardhurat kryesore të ekonomisë familjare janë nga ndihma sociale (94.8%), që përbëjnë 16.5% e fëmijëve të varfër dhe 8.5% e të gjithë fëmijëve në Kosovë.<sup>22</sup> Më shumë të rrezikuar nga varfëria janë familjet e komuniteteve pakicë, sidomos ata nga komuniteti rom, ashkalinj dhe egjiptian. Përkundër kësaj, mbulueshmëria e familjeve të këtyre komuniteteve me SNS ka shkuar duke rënë.<sup>23</sup>

16 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.01/19. 30 mars 2020. Burimi: <https://bit.ly/37MaUqe>

17 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.01/23. 13 gusht 2020. Burimi: <https://bit.ly/3s0x8vw>

18 Instituti GAP. Programi dhe Ligji për rimëkëmbje ekonomike. Mars 2021: Burimi: <https://bit.ly/37Jv6ZT>

19 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.13/19. 14 korrik 2021. Burimi: <https://bit.ly/3vIWeHc>

20 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (e cila nga viti 2021 është shkrire në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve). Strategjia Sektoriale 2018-2022. Burimi: <https://bit.ly/3EZx7Zl>

21 Po aty.

22 UNICEF-programi në Kosovë. Varfëria e fëmijëve në Kosovë. Maj 2010.

23 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (e cila nga viti 2021 është shkrire në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve). Strategjia Sektoriale 2018-2022. Burimi: <https://bit.ly/3EZx7Zl>



Me Strategjinë sektoriale parashihej edhe plotësim-ndryshimi i kornizës ligjore për SNS dhe hartimi i një analize për rishikimin e skemës së ndihmës sociale.

Në gusht të vitit 2019, MPMS ka publikuar koncept dokumentin për ndihmë sociale. Në bazë të analizës së MPMS, disa prej faktorëve që kontribuojnë në ndikim të kufizuar të SNS përfshijnë:

- Mbulueshmërinë e kufizuar të SNS-së, ngase programi mbulon vetëm 35% të familjeve në kuintilin më të varfër të popullsisë;
- Përkeqësimin gradual të shënjestrimit, me shpërndarje të rreth 10% të shpenzimeve në dy kuintilet më të pasura si dhe përzgjedhje të 68% të të varfërve në kuintilin më të varfër në vitin 2016;
- Problemet me zbatim dhe administrim të kornizës ligjore për shkak të kriterëve të përzgjedhjes të cilat nuk janë në përputhje me karakteristikat dhe nevojat e familjeve të varfra në Kosovë;
- Pamjaftueshmërinë e shumës mujore të SNS-së për të plotësuar nevojat bazike të përfituesve, posaçërisht për familjet e mëdha, si dhe vlerën e ulët të pakos së përfitimeve dhe lirimeve në të cilat kanë të drejtë përfituesit e SNS-së; dhe
- Mungesën e koordinimit në mes të SNS-së dhe shërbimeve sociale si dhe atyre të punësimit, si dhe mos-përshtatjen e këtyre të fundit me nevojat dhe profilin e përfituesve të SNS-së.<sup>24</sup>

Shumica e problemeve me SNS rezultojnë nga korniza jo-adekuate ligjore, kufizimi buxhetor, si dhe mungesa e koordinimit dhe mangësitë në kapacitetet institucionale dhe të teknologjisë informative për të ofruar shërbime të integruara të SNS-së.<sup>25</sup>

Si rrugë përpara, koncept dokumenti parasheh ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale, në të cilin parashihen këto masa:

- Largimin e filtrave përjashtues për familjet e varfëra në procesin e aplikimit për ndihmë, siç është kategorizimi i familjeve në bazë të aftësisë për punë, numrit të fëmijëve të ndonjë moshe të caktuar, numrit të anëtarëve të varur të familjes, etj., rrjedhimisht largimin e kriterëve që parashihen me kategoritë I dhe II të ligjit aktual.
- Mundësi përzgjedhjeje dhe përfitimi do të kenë të gjitha familjet të cilat konsiderojnë se janë të varfra dhe të cilat nuk kanë mundësi të plotësojnë nevojat bazike të konsumit.
- Testi i mjeteve financiare që llogarit të gjithë anëtarët e ekonomisë familjare dhe të hyrat e tyre formale të cilat 'monitorohen' në sistemin zyrtar të të dhënave. Në këtë test të ri të mjeteve llogariten të gjithë anëtarët e ekonomisë familjare, duke përfshirë ata që marrin pensione dhe përfitime tjera.

<sup>24</sup> Qeveria e Kosovës. Platforma e konsultimeve. Koncept dokumenti i Skemës së Ndhmës Sociale. Burimi: <https://bit.ly/3y1fhrT>

<sup>25</sup> Po aty.

- Ekonomitë familjare me të hyra financiare për ekuivalentin e të rriturit mbi kufirin e varfërisë përjashtohen nga kualifikimi për SNS. Llogaritja e të hyrave financiare do të përfshijnë gjashtë muajt e fundit çdo herë që bëhet verifikimi i të dhënave (çdo muaj) për të 'normalizuar' distribuimin e të ardhurave financiare të familjeve, gjegjësisht për të mos përjashtuar ato që realizojnë të hyra të parregullta (të kohëpaskohshme, njëhershme, apo vetëm gjatë sezoneve të caktuar).
- Duke pasur parasysh shkallën e lartë të të hyrave joformale në Kosovë siç janë remitencat, të hyrat formale nuk janë matës i përkryer i kushteve të përgjithshme të jetesës së ekonomive familjare. Prandaj, procedura e përzgjedhjes së përfituesve përfshin Testin e Mjeteve të Përafërta (TMP) si hap i dytë të shënjestrimit të përfituesve. TMP-ja i cakton çdo ekonomi familjare pikë që bazohen në pronësinë e aseteve, kushtet e banimit dhe disa karakteristika demografike që lidhen me varfërinë.
- Metodë të re të përlogaritjes së shumës mujore të përfitimit të SNS-së me qëllim të rritjes së nivelit në përputhje me madhësinë e ekonomive familjare. Ky opsion parashihet përdorimin e shkallëve optimale të ekuivalencës të cilat janë llogaritur duke simuluar kombinime të ndryshme të koeficientëve për të rritur dhe fëmijë për të arritur zvogëlimin më të madh në varfëri. Shumës mujore në këtë opsion i është shtuar edhe shtesa e fëmijëve prej 10 euro në muaj për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç.
- Përveç përfitimit monetar – shumës mujore të SNS-së dhe shtesave të fëmijëve – përfituesit e SNS-së do të kenë të drejtë edhe në një sërë përfitimesh dhe lirimesh tjera, përfshirë: i) subvencionimin e një shume të caktuar të shpenzimeve të energjisë elektrike; ii) subvencionimin e shpenzimeve të ujit dhe ngrohjes qendrore; iii) lirim nga pagesa e premie të sigurimit shëndetësor, bashkëpagesave, dhe pagesave tjera të shërbimeve të kujdesit shëndetësor; iv) lirim nga pagesa e librave shkollorë për fëmijët në arsimim fillor dhe të mesëm; v) lirim nga pagesa e semestrit për studentët që janë duke vijuar arsimimin e lartë në universitetet publike në vend; (vi) lirim nga pagesa e shërbimeve të tjera komunale, dhe (vii) lirim nga pagesa e taksës së administratës komunale.
- Zgjatjen e periudhës së ri-aplikimit në një vit në krahasim me gjashtë muaj si është aktualisht për Kategorinë II të SNS-së.
- Të gjithë personat e moshës së punës, 18–64 vjeç të cilët janë të aftë për punë do të jenë të obliguar të regjistrohen në Zyrat e Punësimit. Në krahasim me ligjin aktual, ligji i ri parashihet heqjen e pengesave për punësim ose pjesëmarrje në masat aktive, përfshirë trajnimin profesional. Përfituesit e SNS-së të cilët marrin pjesë në programet e punës publike, trajnime të aftësimi profesional, punë praktike, subvencion të pagave, apo programe tjera qeveritare të punësimit sipas ligjit të ri do të vazhdojnë të marrin përfitime nga SNS-ja për një periudhë të caktuar varësisht nga niveli i pagës si dhe programi në të cilin janë të angazhuar.
- Sanksione më të rrepta si dhe zbatim të tyre për përfituesit e SNS-së të cilët refuzojnë të marrin pjesë në masat aktive të tregut të punës apo shërbimet e punësimit;<sup>26</sup>

26 Opsioni 3 i Koncept dokumentit për Skemën e Ndhmës Sociale. Burimi: <https://bit.ly/3y1fhr>

Për të thjeshtësuar procedurat e administrimit dhe zbatimit të ligjit të ri të SNS, përmirësuar shënjestrimin dhe verifikimin, si dhe harmonizuar me përfitimet dhe shërbimet tjera me qëllim të ofrimit të shërbimeve të integruara do të zhvillohet Regjistri i Unifikuar Social. Ky i fundit parashih ndërlidhjen e modulit të ri të SNS-së me sisteme tjera, siç është regjistri civil, regjistri i veturave, i granteve dhe subvencioneve bujqësore, i të dhënave në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, shërbimet sociale, shërbimet e punësimit, etj. Për të mundësuar zbatimin e të gjitha reformave të parapara, parashihen investime të konsiderueshme në ngritjen e kapaciteteve të, Divizionit të SNS-së, Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes, si dhe të Qendrave për Punë Sociale (QPS).

Nëse aprovohet ligji i ri me këto opsione, pritet që:

- Varfëria të ulet nga 16.3% në 11.5%;
- Zvogëlim të hendekut të varfërisë nga 4.8% në 2.5%;
- Saktësia e shënjestrimin do të rritej nga 64% në skemën aktuale në 68%;
- Mbulueshmëria do të rritej nga 26% në 44%;
- Mjaftueshmëria e nivelit të përfitimit do të rritej nga 39% për qind në 63%;
- Numri i përfituesve do të rritej nga 106,416 në 167,766 persona
- Numri i fëmijëve nën moshën 18 vjeç të cilët përfitojnë shtesa do të rritej nga 55,285 në 68,521;
- Shpenzimet në SNS do të rriteshin për 18 milionë euro në vit, nga 32 milionë në 50 milionë. Nga 18 milionë euro rritje në shpenzime në vit, 10 milionë do të ndahen për shtesat e fëmijëve, ndërsa 8 milionë për reformat e SNS-së të cilat do të rezultojnë në rritje të shumave mujore të përfitimit për familjet e mëdha si dhe në rritje në numër të përfituesve.<sup>27</sup>

Por, ligji i ri për reformën e SNS nuk është aprovuar ende. Si projektligj ka qenë pjesë e programit legjislativ për vitin 2021 por nuk është aprovuar në qeveri. Projektligji është pjesë edhe e programit legjislativ të vitit 2022 dhe parashihet që të aprovohet në qeveri në fund të muajit nëntor.<sup>28</sup>

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Qeveria e Kosovës. Programi legjislativ për vitin 2022. Burimi: <https://bit.ly/3MCwVpX>

## Kredia e Bankës Botërore

Për reformimin e skemës së ndihmës sociale, Qeveria ka kërkuar mbështetje financiare dhe ekspertizë nga BB. Kredia e butë, e cila është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Bankës Botërore më 29 shtator 2021, nuk është ratifikuar ende në Kuvend, as pas dy tentativave.

Arsyetimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të cilët kundërshtuan ratifikimin e marrëveshjes, ishte se 41 milionë euro nga 47 gjithsej parashihet të përdoren si asistencë direkte financiare për përfituesit nga SNS.<sup>29</sup> Sipas deputetëve që kanë refuzuar aprovimin e kredisë, shteti i Kosovës nuk duhet ta bëjë praktikë marrjen e kredisë për pagesë të skemave sociale. Edhe deputetët kundërshtues janë në favor të reformimit të SNS.

Sipas vlerësimit të ndikimit financiar (VNF) të MFPT, kredia prej 47 milionë eurove pritet të shpenzohet deri në vitin 2025, sipas ndarjeve në tabelën më poshtë.<sup>30</sup>

**Tabela 2.** Ndarja sipas viteve e kredisë prej 47 milionë euro

| Kategoria e shpenzimeve   | 2022             | 2023              | 2024              | 2025              | Totali            |
|---------------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Mallra dhe shërbime       | 800,000          | 800,000           | 750,000           | -                 | 2,350,000         |
| Subvencione dhe transfere | 7,325,000        | 10,275,000        | 11,150,000        | 15,000,000        | 43,750,000        |
| Shpenzime kapitale        | 270,000          | 530,000           | 100,000           | -                 | 900,000           |
| <b>Totali</b>             | <b>8,395,000</b> | <b>11,605,000</b> | <b>12,000,000</b> | <b>15,000,000</b> | <b>47,000,000</b> |

VNF deklaron se marrëveshja nuk do ketë kosto shtesë përtej 47 milionë eurove. Por sipas Marrëveshjes për financim, Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar bie dakord t'i japë Qeverisë së Kosovës një kredi, e cila konsiderohet si Financim Koncesionar për qëllimet e 'Kushteve të Përgjithshme', në shumën prej 47 milionë euro sipas planit të shlyerjes së kredisë në tabelën në vijim.<sup>31</sup>

**Tabela 3.** Plani i shlyerjes së kredisë

| Data e afatit të pagesës (në çdo 15 maj dhe 15 nëntor)            | Shuma e kryegjësë së kredisë që shlyhet |
|---|---|
| Duke filluar nga 15 nëntori 2026 dhe duke përfshirë 15 majin 2046 | 1.65%                                   |
| Duke filluar nga 15 nëntori 2046 dhe duke përfshirë 15 majin 2051 | 3.40%                                   |

Pas kërkesës së Institutit GAP derjtuar MFPT-së për të na informuar për koston reale të kredisë, MFPT ka dërguar një përlllogaritje të re. Sipas përlllogaritjeve, deri në vitin 2051, Kosova duhet t'i kthejë 8.8 milionë euro interes. Për 20 vitet e para, pas pesë viteve grejs periudhë, duke filluar nga viti 2026, Kosova do të paguajë nga 1.65% të shumës së kredisë ose si pagesë e kryegjësë në shumë prej 1,551,000 euro në vit (gjithsej 31,020,000 euro). Ndërsa, gjatë pesë viteve të fundit, duke filluar nga viti 2046, do të paguhet nga 3.4% e shumës së kredisë, apo si pagesë e kryegjësë në shumë prej 3,196,000 euro në vit (gjithsej 15,980,000 euro). Kësisoj, për kredinë 47 milionë euro, Kosova duhet t'kthejë gjithsej 55.8 milionë euro deri në vitin 2051. Në këto llogaritje përfshihet tarifa e zotimit në bilancin e financimit të patërhequr, si dhe tarifa e shërbimit dhe tarifa e kamatës mbi bilancin e kredisë së tërhequr, ashtu siç parashihen në Marrëveshjen e Financimit.

<sup>29</sup> Kuvendi i Kosovës. Transkripti i seancës plenare të nisur më 20 janar 2022. Burimi: <https://bit.ly/3MyX496>

<sup>30</sup> Kuvendi i Kosovës. VNF i Projektligjit. Burimi: <https://bit.ly/3vW6vcl>

<sup>31</sup> Kuvendi i Kosovës. Marrëveshja e financimit. Burimi: <https://bit.ly/38A33fa>

## Përfundim

Në këtë analizë të shkurtër, Instituti GAP ka përshkruar historikun e Skemës së Ndihmës Sociale, si një nga skemat e vetme e cila merr për bazë varfërinë e përfituesve. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme që të reformohet SNS me qëllim që të përfshijë më shumë familje të varfëra dhe shuma mujore e kompensimit të jetë më e lartë se kufiri i varfërisë. Por, këto analiza të gjendjes dhe nisma ligjore nuk kanë marr aprovimin përfundimtar në Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.

Kriza shëndetësore e shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe rritja e çmimeve të konsumit ka bërë që trendi i rënies së varfërisë viteve të fundit të kthehet në kah të kundërt dhe të dhënat e fundit të Bankës Botërore tregojnë për rritje të nivelit të varfërisë në Kosovë. Duke parë këtë, Qeveria e Kosovës kërkoi nga BB kredi për reformën e SNS. Mirëpo, kredia përfshin edhe transfere sociale tek familjet përfituese dhe ky fakt ka bërë që ratifikimi i marrëveshjes të dështojë dy herë në Kuvendin e Kosovës. Përkundër asaj se Kuvendi e ka refuzuar dy herë këtë marrëveshje, Qeveria nuk ka hequr dorë nga aprovimi i saj në Kuvend.

Instituti GAP vlerëson se marrja e rreth 43 milionë eurove kredi për të paguar një pjesë të transfereve për familjet që janë pjesë e Skemës, është e panevojshme financiarisht dhe mund të shërbejë si precedent jo i mirë edhe në të ardhmen. Krahasimi i kësaj situatë më kohën e pandemisë Covid-19, kur qeveria kishte marr kredi të një natyre të ngjashme për të mbuluar qoftë pagesën e shtesave tek pensionet apo masat tjera mbështetëse, është jo adekuat meqë në atë kohë qeveria ishte përballur me rënie të theksuar në të hyrat buxhetore dhe njëkohësisht rritje të shpenzimeve për menaxhimin e dëmëve nga pandemia. Ndërsa aktualisht, rritja e çmimeve ka ndikuar që të hyrat qeveritare të rriten, ngase qeveria nuk ka suspenduar përkohësisht ose ulur tatimet apo akcizat. Kjo ka bërë që Qeveria të mbledh të hyra të mjaftueshme për të financuar reformën e SNS me rreth 12 deri 15 milionë euro mjete shtesë në vit përgjatë katër viteve të ardhshme, pa pasur nevojë për kredinë e BB. Këtë e dëshmon edhe vendimi i muajit prill i Qeverisë së Kosovës për ndarjen e subvencioneve prej 100 euro për të gjithë përfituesit e skemave sociale, të gjithë studentët dhe të gjithë të punësuarit që marrin pagë nën një mijë euro. Në total u zotuan 100 milionë euro.<sup>32</sup>

Me qëllim të reformimit më të shpejtë të SNS dhe aprovimit të Ligjit të ri për SNS, qeveria duhet të heq dorë nga insistimi për të ratifikuar marrëveshjen e kredisë me BB, ose ta ndryshojë atë duke marr kredi dhe ekspertizë vetëm për asistencë teknike që lidhet direkt me reformën dhe jo transfere sociale. Në të kundërtën, kjo mund të shndërrohet në praktikë të dëmshme në të ardhmen, duke marr parasysh presionet buxhetore si pasojë e rritjes së buxhetit për skemat sociale dhe kërkesat për rritjen e pagave në sektorin publik.

32 Zyra e Kryeministrit. Mbi 100 milionë euro mbështetje për qytetarët. 12 prill 2022. Burimi: <https://bit.ly/3H717YV>





Funded by  
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e  
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"  
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



KOSOVO 2.0

